



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

PËRMIRËSOHEN TREGUESIT SHËNDETËSORË

PROGRAMI I REHABILITIMIT TË 300 QENDRAVE SHËNDETËSORË

VIJON KANTIERI I SHËNDETËSISË

AKREDITIMI I QENDRAVE SHËNDETËSORË

SHËRBIM CILËSOR AFËR VENDBANIMIT

MAMOGRAFI FALAS GJITHË VITIN

TASK FORCA E USHTRIMIT TË KONTROLLIT TË BARNAVE

DITARI JAVOR

15 Prill – 21 Prill

Raporti i Parë Kombëtar i Sëmundshmërisë Kronike, fakton me të dhëna konkrete orientimin e drejtë të politikave dhe programeve shëndetësore, që kanë sjellë ulje të vdekshmërisë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe tumorale. 1 milion qytetarë e kanë kryer deri tani Kontrollin Mjekësor Bazë, duke ndikuar në identifikimin në kohë të sëmundjeve dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve. Sot mbulohet 80 % e nevojës për trajtimin e sëmundjeve kardiake me financim publik.V

Nga veriu në jug, vijon rehabilitimi i qendrave të kujdesit parësor. Në kuadër të programit të 300 qendrave shëndetësore, është rehabilituar ambulanca Dunavat në Gjirokastër. Është rehabilituar edhe ambulanca 10/1 në Tiranë, e cila ofron kushte më të mira pune për stafin mjekësor por edhe një shërbim më cilësor në portën e parë të kujdesit shëndetësor për 39 mijë banorët e Njësi Administrative 3 dhe 4 në Tiranë.

Vijon puna për transformimin e kujdesit parësor. Qendra Shëndetësore e Saukut po përfundon rindërtimin e plotë, me mbështetjen e projektit "Shëndet për të Gjithë". Me përfundimin e investimit do të sigurohet shërbim cilësor për 13 mijë banorët e Saukut.

Më shumë se 280 qendra shëndetësore kanë nisur procesin e akreditimit, i cili ka të bëjë me përmbushjen e standardeve bazë që duhet të ketë çdo qendër shëndetësore për sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve për qytetarët. Të gjithë strukturat shëndetësore publike dhe jo publike duhet të përmbushin këtë proces.

Vijon patronazhimi i spitaleve rajonale dhe bashkiake nga spitalet universitare të Tiranës. Materniteti i Krujës po patronazhohet nga mjekët e maternitetit "Mbretëresha Geraldinë", të cilët bashkë me ekipin e mjekëve të Krujës, po mundësojnë në këtë spital edhe ndërhyrjet e vështira.

Vetëm gjatë 3 muajve të parë të vitit 2019, me mamografët e lëvizshëm kanë marrë shërbimin afër vendbanimit 810 gra. Në poliklinika, spitale dhe me mamografët e lëvizshëm, shërbimi i mamografisë ofrohet falas, gjatë gjithë vitit.

Task Forca e ushtrimit të kontrollit të barnave në dy muaj ka kontrolluar 121 farmaci duke vendosur 46 masa për shkelje administrative të ndryshme. Shkeljet e kryera nga farmacistët lidhen me mungesë të recetave sipas klasifikimit, barna pa recetë, për ruajtjen dhe shpërndarjen e barnave, regëtim të barnave spitalore, ushtrim të aktivitetit në mungesë të farmacistit etj.